



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel/Fax 04 22268141; 22268142

Nr. 236 Prot.

Tiranë, më 27.03.2017

V E N D I M

Nr. 61, datë 27/03/2017

"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimit të Komisionerit nr.162, datë 27.12.2016 dhe ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë procesit të emërimeve nga institucioni i Drejtorisë Bujqësisë Shkodër, prej datës 02.11.2016 e në vazhdim"

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe nenin 34 e vijues të Rregullores, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 162, datë 27.12.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Shkodër dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë", në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Shkodër,

VËREJ SE:

Me Vendimin Nr. 138, datë 30.12.2015, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e procesit të mbikëqyrjes së përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil. Bazuar në këtë vendim ka vijuar mbikëqyrja edhe në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Shkodër. Ky proces është përmblyllur me Vendimin Nr. 162, datë 27.12.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Shkodër dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Drejtorinë e Bujqësisë Shkodër, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike si dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur, duhet të marrin masa dhe të tregojnë kujdes, që procedurat që kanë lidhje me menaxhimin e shërbimit civil dhe janë kryer në mënyrë elektronike, t'i materializojnë ato edhe në formë shkresore, duke respektuar mënyrën dhe elementët që duhet të përmbajë kopja në letër e dokumentit elektronik, të përcaktuara në ligjin nr. 9880, datë 25.02.2008, *“Për nënshkrimin elektronik”*, i ndryshuar, ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010, *“Për dokumentin elektronik”* si dhe në udhëzimin nr. 1, datë 31.12.2012, të Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit të Komunikimit, *“Për vërtetimin e kopjes në letër të dokumentit elektronik nga institucionet publike”*.

Me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil nga nëpunësit përgjegjës, në përputhje me hierarkinë administrative, ashtu dhe nga institucionet e ngarkuara nga ligji për mbikëqyrjen e shërbimit civil, këto kopje duhet të trajtohen në përputhje me kërkesat e ligjit për arkivat dhe normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Në këtë këndvështrim, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore duhet të finalizojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, duke u kujdesuar që të merret mendimi i Departamentit të Administratës Publike dhe më tej t'i depozitojë ato në arkivin e institucionit, si dhe pranë Departamentit të Administratës Publike.

3. Njësia e burimeve njerëzore në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Shkodër, në kuptim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe të vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, duhet t'i kërkojë punonjësit ***** me detyrë *“Përgjegjës i Sektorit për Pukën”*, në Drejtorinë e Bujqësisë Shkodër, të paraqesë diplomën e përfundimit të programit të studimeve *“Master i Shkencave”* dhe listën e notave, me qëllim që të provojë se punonjësi i përmbush kushtet për të qenë pjesë e shërbimit civil, në rrethanat kur afati i përcaktuar në ligj për dorëzimin e tyre ka përfunduar.

Një kopje e këtyre dokumenteve, të cilët duhet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara nga noteri, duhet t'i dërgohet Departamentit të Administratës Publike dhe një kopje duhet të bëhet pjesë përbërëse e dosjes personale të nëpunësit.

Pas marrjes së dokumentacionit të mësipërm, njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, duhet të vijojë me përfundimin e procedurës së deklarimit të statusit të punësimit për punonjësin *****.

4. Për të rregulluar ligjshmërinë e procesit të ristrukturimit në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Shkodër, njësia përgjegjëse (DAP), në kuptim të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe nenit 111, 113, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në lidhje me punonjësit ***** dhe *****, të cilët janë transferuar në pozicione jashtë shërbimit civil, duhet të anulohet pjesërisht aktin nr. 3111/1, datë 24.06.2015, “Mbi transferimin e disa nëpunësve për shkak të ristrukturimit të Drejtorisë së Bujqësisë Shkodër”, duke vepruar si më poshtë:

- Të anulohet pika 3, e aktit administrativ nr. 3111/1, datë 24.06.2015, “Mbi transferimin e disa nëpunësve për shkak të ristrukturimit të Drejtorisë së Bujqësisë Shkodër”, në lidhje me transferimin e punonjësit *****, në pozicionin e punës “Specialist”, pranë Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural.
- Të anulohet pika 4, e aktit administrativ nr. 3111/1, datë 24.06.2015, “Mbi transferimin e disa nëpunësve për shkak të ristrukturimit të Drejtorisë së Bujqësisë Shkodër”, në lidhje me transferimin e punonjësit *****, në pozicionin e punës “Specialist”, pranë Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural.
- Njësia përgjegjëse, të nxjerrë aktet individuale të lirimit nga shërbimi civil, për punonjësit ***** dhe *****, për shkak të përfundimit të marrëdhënies së punës, në kuadër të ristrukturimit të Drejtorisë së Bujqësisë Shkodër.
- Në kuptim të nenit 50, pika 8, germa “a”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, t’u njohë punonjësve ***** dhe ***** të drejtën që brenda periudhës 2-vjeçare, nga data e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurën e lëvizjes paralele apo të ngritjes në detyrë, në pozicione pune të shërbimit civil dhe të njoftohen punonjësit për këto akte.

5. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **30** ditë nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues nr. 162, datë 27.12.2016, të Komisionerit, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë realizimit të procedurave për rekrutim, transferim, ngritje në detyrë, në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Shkodër, prej datës 02.11.2016 që është momenti i verifikimit të kryer në kuadër të mbikëqyrjes e në vazhdim, me vendimin nr. 32, datë 13.02.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 162, datë 27.12.2016 dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga institucioni i Drejtorisë së Bujqësisë, Shkodër, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 02.11.2016 e në vazhdim”, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 162 datë 27.12.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Institucionin Drejtorisë së Bujqësisë Shkodër dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Shkodër, dhe subjekti u njoftua me shkresën nr. 113/2 prot., datë 13.02.2017 “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Bazuar në procesverbalin dt. 10.03.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe nënshkruar edhe nga personat e kontaktit të institucionit të Drejtorisë së Bujqësisë Shkodër, dhe pas shqyrtimit të materialeve shkresore të administruara në përfundim të procesit të verifikimit, rezultoi sa më poshtë vijon:

- Në zbatim të pikës 2 të vendimit, Njësia e Burimeve Njerëzore të institucionit ka hartuar përshkrimet e punës për pozicionet e shërbimit civil. Me shkresën nr. 46 prot., datë 23.01.2017 “Kërkohe mendim për përshkrimet e pozicioneve të punës”, i është kërkuar Departamentit të Administratës Publike që të konfirmojë nëse përshkrimet e punës janë hartuar në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar, siç përcaktohet në pikën 19, të Vendimit Nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”. Në momentin e verifikimit, nga ana e Departamentit të Administratës Publike nuk është kthyer përgjigje në lidhje me shkresën e sipërcituar. Për këtë arsye, përshkrimet e punës nuk i janë dërguar ende për nënshkrim nëpunësit të ngarkuar me këtë detyrë (*Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave*).
- Në pikën 3 të vendimit paralajmërues të Komisionerit, njësia e burimeve njerëzore në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Shkodër, në kuptim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, i ka kërkuar punonjësit ***** me detyrë “Përgjegjës i Sektorit për Pukën”, në Drejtorinë e Bujqësisë Shkodër, të paraqesë diplomën e përfundimit të programit të studimeve “Master i Shkencave” dhe listën e notave, me qëllim që të provojë se punonjësi i përmbush kushtet për të qenë pjesë e shërbimit civil, në rrethanat kur afati i përcaktuar në ligj për dorëzimin e tyre ka përfunduar.

U konstatua se punonjësi nuk kishte paraqitur diplomën përkatëse edhe pse kjo i ishte kërkuar nga titullari i institucionit me shkresën nr. 422 prot., datë 24.10.2016, “Kërkesë”. Njëkohësisht i është kërkuar mendim edhe Departamentit të Administratës Publike me shkresën nr. 443 prot., datë 07.11.2016, si edhe Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave me shkresën nr. 512, datë 06.12.2016.

Në momentin e verifikimit, institucionit nuk i është kthyer përgjigje në lidhje me shkresat e sipërcituara.

- Në pikën 3 të vendimit paralajmërues të Komisionerit, për të rregulluar ligjshmërinë e procesit të ristrukturimit, njësia përgjegjëse (DAP), në lidhje me rastin e punonjësve ***** dhe ***** duhet që në zbatim të nenit 50, pika 8, germa “a”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, t’u njohë punonjësve ***** dhe ***** të drejtën që brenda periudhës 2-vjeçare, nga data e

përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurën e lëvizjes paralele apo të ngritjes në detyrë, në pozicione pune të shërbimit civil dhe të njoftohen punonjësit për këto akte.

Ashtu sikundër është pasqyruar edhe në procesverbalin e mbajtur në subjekt gjatë procesit të verifikimit, rezulton se ******, kishte mbushur moshën e pensionit, ndërsa ****** kishte ndërruar jetë.

Për sa u përket më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin nr. 162 datë 27.12.2016, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Shkodër dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*, të Komisionerit, rezulton se nga ana e njësive së burimeve njerëzore të institucionit janë zbatuar të gjitha rekomandimet e lëna në vendimin paralajmëruar.

Në përfundim të procesit të verifikimit në subjekt, lidhur me ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera gjatë realizimit të procedurave për rekrutim, transferim, ngritje në detyrë, në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Shkodër prej datës 02.11.2016 që është momenti i verifikimit të kryer në kuadër të mbikëqyrjes e në vazhdim, rezultoi se aktet e emërimeve në pozicionet e shërbimit civil janë nxjerrë nga njësia përgjegjëse, DAP, sipas parashikimeve të pikës 19, të kreut IV dhe pikës 22 të kreut VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; nenin 90, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe 34 të Rregullores, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit për zbatimin e Vendimit nr. 162, datë 27.12.2016 në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Shkodër.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësive së burimeve njerëzore të institucionit të Prefektit, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit nr. 162, datë 27.12.2016, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Shkodër dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*.
3. Verifikimin e mëtejshëm të pikave 2, 3 dhe 4 të dispozitivit të Vendimit nr. 162, datë 27.12.2016, për të cilat kërkohet reagimi i Njësive Përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike.
4. Konstatimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative, të kryera gjatë procesit të emërimeve nga institucioni i Drejtorisë së Bujqësisë Shkodër, prej datës 02.11.2016 e në vazhdim.

5. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Drejtorisë së Bujqësisë Shkodër, Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA

Punoi: Joni Marko, Specialist i KMSHC

Pranoi: Enkelejda Hebibasi, Drejtor i Çështjeve Juridike & Marrëdhënieve me Jashtë